



Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Komuna e Malishevës

31 Dhjetor 2011

Përmbajtja

Përmbledhja.....	2
1 Hyrje.....	4
2 Opinioni i auditimit.....	6
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit paraprak.....	11
4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar.....	12
5 Pasqyrat Financiare – Pajtueshmëria me kornizën e raportimit dhe cilësinë e informatave.....	13
6 Menaxhmenti Financiar.....	14
▪ 6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake).....	14
▪ 6.2 Shpenzimet.....	16
▪ 6.3 Asetet.....	19
▪ 6.4 Trajtimi i borxheve.....	19
▪ 6.5 Raportimi dhe afati kohor aktual ne procesin e pergjithshëm të buxhetit.....	20
7 Kontrollat e menaxhmentit.....	21
▪ 7.1 Sistemi i kontrollit të brendshëm.....	21
▪ 7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm.....	21
8 Konkluzioni i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës së Malishevës.....	22
Shtojca I. Format e ndryshme të opinioneve të auditimit bazuar në ISSAI 400.....	24
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	26
Shtojca III: Komentet e Komunës dhe përgjigjet e Grant Thorntonit.....	28

Përmbledhje

Grant Thornton Sh.p.k, në emër të Zyres së Auditorit të Përgjithshëm, ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi jonë është kryer në përpuethshmëri me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (“ONISA”) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion mbi pasqyrat financiare.

Ju lutem gjeni më poshtë një ekstrakt të marrë nga opinionimi jonë i auditimit nga faqja 6 të këtij dokumenti:

Sipas mendimit tonë, përveç impakteve të mundëshme të çështjeve të diskutuara në paragrafin 1 dhe 3 të bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik bazuar në Paranë e Gatshme (“SNKSP”) Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore

Porositë kryesore ndaj Kryetarit, të cilat na shpjen në kualifikim të opinionit janë

1. Komuna nuk ka një listë të duhur të pagesave nga palët e treta. Për shkak të natyrës së të dhënave të mbajtura në kontabilitet dhe sistemeve operative për pagesat nga palët e treta, si dhe mungesa e kontrolleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryejë teste të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të verifikuar plotësinë e pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011;
2. Shpalosje të kërkuara nga SNKSP Raportimi Financiar në Baza të Parasë së Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 në Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore nuk janë kryer nga Komuna gjatë pregaditjes së pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011. Në veçanti, çështjet në vijim mungojnë ose janë shpalosur në mënyrën të gabuar në pasqyrat financiare:
 - Të arkëtueshmet (përdoret për organizata që arkëtojnë të hyra) nuk janë të kompletuara në mënyrë të duhur;
 - Pagesat nga palët e treta, në shënimin 12, Pasqyra e pranimit dhe pagesave nuk është e kompletuar për vitin që ka përfunduar me 31 Dhjetor 2011;
 - Komuna nuk ka shpalosur në shënimet e pasqyrave, inventarin e saj si kërkohet nga neni 16.1 i Rregullës Financiare nr. 07/2011;

- Siç paraqitet në shënimin 29 në Pasqyrat Financiare, Detyrimet Kontingjente, Komuna ka raportuar detyrim kontingjent në vlerë prej 18 mijë Euro, ndërsa detyrimet kontingjente të paraqitura nga Avokati I Popullit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011 janë 735 mijë Euro;
 - Komuna nuk ka aplikuar kodet e duhura ekonomike për disa të ardhura dhe shpenzimet të te shpalosura në shënimin 8 dhe shënimin 15 të pasqyrave financiare, prandaj ne nuk jemi në gjendje për të përcaktuar se cila ndryshimet mund të jenë të nevojshme për informatat financiare në pasqyrat financiare të Komunës.
3. Ekzistojne disa mangësi dhe pasiguri qe ndikojne ne raportimin financiar te Prones, Pajimeve dhe Impianteve, si vijon:
- a. Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës për Pronën, Paisjet dhe Impiantet;
 - b. Komuna nuk posedon ndonjë list të detajuar mbi Pronën e Patundshme duke përfshirë dokumentet e pronësitë së atyre të pasurive dhe as të informacioneve mbi statusin e regjistrimit në gjykatën komunalet për regjistrim të pasurive;
 - c. Komuna nuk i ka raportuar të dhënat financiare krahasuese për Pronën, Paisjet dhe Impiantet.

Për shkak të natyrës së regjistrimeve dhe mangësive tjera të përshkruara më sipër, ne nuk ishëm në gjendje të arrijmë siguri të mjaftueshme në lidhje me shpalosjet, ekzistencën, tërësinë, saktësinë dhe vlerësimin e pronës, pajisjeve dhe impianteve të Komunës me 31 Dhjetor 2011.

Të dhënat e prezentuara në Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar 31 Dhjetor 2011 janë të prezentuara në Euro ndërsa të dhënat krahasuese janë paraqitur në mijë Euro.

Kontrollat e Brendshme

Auditimi jonë ka indentifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë përshkruar në më shumë detaje brenda këtij raporti.

Konkluzioni jonë është se sistemet e brendshme të Komunës nuk janë të dizajnuara për të eliminuar dobësitë evidente si dhe nuk zbatohen sic duhet.

Në mënyrë që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollet e brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguroheni se:

- Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me udhëzimin aktual administrativ dhe SNKSP;
- Një listë e plotë e pronës, ndërtesave dhe pajisjeve mirëmbahet;
- Një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave të mirëmbahet;
- Janë marrë masat për rritje të mbledhjes së të hyrave nga taksa të ndryshme;
- Ligji Nr. 03/L-241 i ndryshuar 04/L-042 'Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë' është i zbatuar në mënyrë të plotë; dhe
- Njësia e Auditimit dhe Komiteti i auditimit janë themeluar.

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të komentuar mbi gjetjet e prezentuara në këtë raport. Menaxhmenti ka rënë dakord të bëjë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet tona në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm, pasqyrat financiare, shpërblimet dhe pagat, prokurimin, llogaritë e arkëtueshme dhe krijimin e njësisë së Auditimit dhe Komisionit të Auditimit.

1. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Komunës të përgadis pasqyrat financiare në përputhshmëri me Rregullat Financiare 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar nën Baza të Kontabilitetit me Paranë e gatshme”.

Grant Thornton LLC, në emër të Zyres së Auditorit të Përgjithshëm (“ZAP”), është përgjegjës për kryerjen e auditimit të rregullt vjetor të pasqyrave financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, i cili përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Financiare dhe të dhënave të tjera financiare dhe siguron vlerësim:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të saktë për llogaritë dhe çështjet financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet përputhen me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Në përshtatshmërinë e kontroleve të brendshme dhe funksionit të auditimit të brendshëm; dhe
- Për çfardo çështje të rëndësishme që ndërlidhet me auditimin.

ZAP-i ka kryer auditimin e ndërmjetmë të Komunës. Gjatë asaj periudhe të procesit të auditimit i kanë adresuar zgjidhjen e rekomandimeve të dhëna më herët Komunës si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Bazuar në këtë ata kanë dhënë rekomandime për menaxhmentin. Rekomandimet e tyre kanë përfshirë gjithashtu këshilla lidhur me përmirësimet për pasqyrat financiare që të jenë në përputhshmëri me Instruksionin Financiar 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (“SNKSP”) për “Raportimin Financiar të Kontabilitetit në Baza të parasë së gatshme”. Kjo është e përfshirë gjithashtu si këshillë lidhur me përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare. Rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë dorëzuar nëpërmjet memorandumit të auditimit në Dhjetor 2011.

Në mënyrë që të përmbushet përgjegjësia jonë për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- Kemi krahasuar Pasqyrat Vjetore Financiare të komunës me buxhetin e aprovuar për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011;
- Kemi përcaktuar nëse Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës janë përgaditur në përputhshmëri me SNKSP “Raportimi Financiar i Kontabilitetit në Baza të parasë së gatshme” dhe Rregullat Financiare 07/2011;
- Kemi përcaktuar nivelin e materialitetit, si prag për lehtësim në përcaktimin e llojit të mendimit që duhet dhënë për pasqyrat financiare;
- Kemi përdorur një kombinim të gjykimit dhe mostrimit të thjeshtë për të përzgjedhur transaksionin për testim;

- Kemi kryer teste substanciale të transaksioneve financiare; dhe
- Jemi mbështetur në një kombinim të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumentave dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe drejtësinë e transaksioneve financiare;

Në këtë raport ne përmbledhim gjetjet e auditimit dhe japim mendimin tonë për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

ONISA ka vendosur kritere të veçanta që përcaktojnë llojin e mendimit që do duhej dhënë në lidhje me mendimin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës.

Keto janë të vëna në mënyrë më të plotë në Shtojcën 1.

2. Opinioni i Auditimit

Raporti i auditorit të pavarur

Grant Thornton LLC
 Rr. Rexhep Mala 18
 10 000 Prishtina
 Republic of Kosovo

T +381 38 247 771
 T +381 38 247 801
 F +381 38 247 802
www.grant-thornton.com.mk

Për Kuvendin Komunal
 Komuna e Malishevës, Kosovë

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të Komunës së Malishevës (“Komuna”), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011, një krahasim të buxhetit dhe shumave aktuale, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik-SNKSP “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme” dhe me Rregullin Financiar Nr. 07/ 2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore dhe për kontrollin të brendshëm të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Për shkak të çështjeve të përshkruara në paragrafët Baza për Mohim të Opinioneve, ne nuk ishim në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit në mënyrë që të sigurojmë një bazë për opinionin të auditimit.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë gabim ose mashtrim. Gjatë vlerësimit të riskut, auditori konsideron kontrollin e brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të



dizajnojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në ato rrethana, por jo për qëllimin e shprehjes së një mendimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezentimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të siguruar bazë për mendimin tonë të kualifikuar

Bazat për Opinion të Kualifikuar

1. Komuna nuk mban ndonjë listë të pagesave nga palët e treta. Për shkak të natyrës së të dhënave të mabjtura në sistemet kontabël dhe operative për pagesat nga palët e treta, gjithashtu për arsye të mungesës së një kontrolli alternativ të implementuar nga menaxhmenti, nuk kemi qenë në gjendje të kryejmë teste të mjaftueshme dhe të duhura të auditimit për të verifikuar plotësinë e pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011
2. Komuna nuk ka bërë disa shpalosje të cilat kërkojnë nga SNKSP -Raportimi Financiar nën Kontabilitetin e Parasë së Gatshme dhe Rregulles Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor Të Organizatave Buxhetore. Në veçanti, çështjet e paraqitura më poshtë janë lënë jashtë ose janë shpalosur në mënyrë të parregullt në pasqyrat financiare:
 - Të arkëtueshmet (të përdorura për mbledhjen e të hyrave të organizatave) nuk janë kompletur në mënyrë të përshtatshme;
 - Pagesat nga palët e treta, në shënimin 12 të Pasqyrës për Pranime të parasë së gatshme dhe pagesa nuk janë shpalosur të gjitha për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011
 - Komuna nuk ka shpalosur në shënimet e pasqyrave, inventarin e saj siç kërkohet nga neni 16.1 të Rregulles Financiare nr.07/2011
 - Siç paraqitet në shënimin 29 në Pasqyrat Financiare të Detyrimeve Kontingjente, Komuna ka raportuar detyrim kontingjent në vlerë prej 18 mijë Euro, ndërsa detyrimet kontingjente të paraqitura nga Avokati i Popullit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011 janë 735 mij Euro;
 - Komuna nuk ka aplikuar kodet e duhura ekonomike për disa të ardhura dhe shpenzime të shpalosura në shënimin 8 dhe shënim 15 në pasqyrat financiare, prandaj ne nuk jemi në gjendje për të të përcaktuar se cilat ndryshimet mund të jenë të nevojshme për informatat financiare në pasqyrat financiare të Komunës.
3. Ekzistojnë një numër i imangësive dhe pasigurive që ndikojnë raportimin financiar të pronës, impianteve dhe pajisjeve të Komunës si në vijim:
 - a. Komuna nuk ka mbajtur një regjistër të përgjithshëm të pronës, impiantit dhe pajisjeve të Komunës;
 - b. Komuna nuk ka ndonjë listë gjithëpërfshirëse të detajuar të pasurive të paluajtshme duke përfshirë dokumentet e pronësisë për prona të tilla dhe informacionin mbi



statusin e regjistrimit në emër të Komunës në gjykatën vendore për regjistrim të pasurive të palluajtshme;

- c. Komuna nuk ka raportuar informacion krahasues financiarë të Pronës, Impiantit dhe Paisjeve.

Për shkak të natyrës së regjistrimeve dhe mangësive tjera të përshkruara më sipër, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të mjaftueshme në lidhje me shpalosjet, ekzistencën, tërësinë, saktësinë dhe vlerësimin e pronës, pajisjeve dhe impianteve të Komunes me 31 Dhjetor 2011.

Opinion i Kualifikuar

Sipas mendimit tonë, përveç impakteve të mundëshme të çështjeve të diskutuara në paragrafin 1 dhe 3 të bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik bazuar në Paranë e Gatshme ("SNKSP") Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore.

Rishikimi i Përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjitha aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara të krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare

Përgjegjësia e menaxhmentit për përputhshmërinë

Menaxhmenti është përgjegjës për pregaditjen dhe implementimin e kontrolleve të brendshme për të siguruar se aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzimet mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tone në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzioni mbi përputhshmërinë

Bazuar në rishikimin tonë, për shkak të ndikimit në pasqyrat financiare të çështjeve të shpjguara në paragrafët 1 dhe 3 të “bazat për mendim të kualifikuar” dhe çështjeve të tjera të theksuara në pikat 3 dhe 8 të këtijë raporti, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e pasqyruara dhe pasqyrat financiare që duhet të kenë vëmendjen tonë gjatë rishikimit, nuk janë në përputhshmëri me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen si më poshtë:

1. Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK. Megjithatë, pasi që SIMFK nuk është duke u përdorur për regjistrimin e pagesave nga palët e treta, pronën, pajisjet dhe impiantet ose të arkëtueshmet, nuk mund të përdoret për të pregaditur pasqyra financiare gjithë përfshirëse.

2. Edhe pse Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar kanë nënshkruar Deklaratat lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka qenë në gjendje të dorëzojë një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën Serbe deri në fund të auditimit tonë.
3. Komuna nuk ka zbatuar një sistem gjithëpërfshirës dhe të automatizuar të faturimit dhe nuk mban lista apo llogari të veçanta e complete për të gjithë debitorët e saj në lidhje me taksat e ndryshme. Vetëm mbledhja e parasë së gatshme nga niveli i të hyrave regjistrohet. Mungesa e saktësisë dhe tërësisë do të ndikojnë në të ardhurat që Komuna mund të fitojë dhe aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë për të raportuar një normë të saktë të mbledhjes, si dhe monitorimin e mbledhjes së të ardhurave vetanake në kohën e duhur.
4. Ne kemi identifikuar disa raste të mosrespektimit të ligjit Nr. 03/L-241 dhe 04/L-042 “Ligji mbi Prokurimin Publik në Kosovë” (i amendamentuar). Mos përputhje të tilla janë të lidhura me procedurat e kërkuara, të cilat komuna nuk i ka kryer dhe dokumentuar.
5. Edhe pse Komuna mund të përfshihen në disa raste të vogla ligjore dhe është e mundur që rrjedha e ardhshme e parasë mund të jetë e nevojshme në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka hartuar dhe zbatuar asnjë procedurë për informacion të plotë, të saktë dhe të besueshëm për dispozitat e regjistrimit dhe detyrimeve kontigjente.

Grant Thornton LLC

Prishtina, Kosovo

29 Qershor 2012

3. Gjendja e rekomandimeve të vitit paraprak

Letër menaxhmenti ynë, për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2010, ka identifikuar gjashtë rekomandime kryesore. Përpos themelimit të Komitetit të Auditimit, rekomandimet tjera nuk janë ndjekur dhe si rezultat ato mbbesin të vlefshme edhe për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2011:

- Përgatitja e pasqyrave financiare të komunës duhet të përfshijë procedurat dhe mjetet që janë projektuar për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare.
- Të mbajë një regjistër gjithëpërfshirës të PPI., regjistrimin , vlerësim dhe do të kryejë numërimin vjetor
- Në rekomandojmë Komunës të ndërmer hapa për përmirësimin e faturimit dhe sistemet kontabël në mënyrë që të sigurohen kontrole të sigurta, efikase dhe efektive në faturim dhe të ardhurat. Përmirësimi i procedurave të lidhura me sisteme të tilla do të mundësojë menaxhmentit të monitoroj dhe menaxhoj rreziqet e konsiderueshme, dhe për të siguruar që vendimet që lidhen me buxhetin, planifikimin dhe mbledhjen e të ardhurave janë kryer në mënyrë të duhur.
- Komuna duhet të vendosë procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv gjatë procedurës së tenderimit në tërësi në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi
- Komuna duhet të zhvillojë politika dhe procedura të shkruara për subvencione dhe transfere dhe duhet të vendosë procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Deshtimi në adresimin e plotë të këtyre rekomandimeve, ka rezultuar të kemi gjetje të ngjashme si në vitin 2010.

4. Rezultati financiar krahasuar me buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit Aktual në Pasqyrat Financiare të krahasuar me Buxhetin e Aprovuar tregon:

Table 1: Përshkrimi i buxhetit dhe shpenzimeve aktuale
Shumat ne mijë Euro

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Arkëtimet/ Shpenzimet 2011	Arkëtimet/ Shpenzimet 2010
I.Total arkëtimet dhe transferet e donacioneve	9,583	9,984	9,388	7,663
Granti Qeveritarë-Buxheti	8,748	8,868	8,621	7,016
Të hyrat vetanake	834	834	596	639
Donacionet vendore		282	171	8
Donacionet e jashtme				
II.Totali i shpenzimeve	9,583	9,984	9,388	7,663
Pagat dhe mëditjet	5,899	6,028	5,794	4,394
Mallrat dhe shërbimet	713	765	750	656
Shërbimet Komunale	157	157	156	156
Subvencionet dhe transferet	62	62	61	60
Investimet Kapitale	2,752	2,972	2,627	2,397
Rezervat	-	-	-	-
Diferenca I-II	-	-	-	-

Në bazë të të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, ne mund të shohim se buxheti final i Komunës së Malishevës gjatë vitit 2011 ka qenë 9,984 mijë Euro. Total shpenzimet për vitin 2011 kanë qenë 9,388 mijë Euro, ose përafërsisht 94% e buxhetit final. Buxheti i pashpenzuar në fund të vitit 2011 ka qenë 599 mijë Euro, ose përafërsisht 6% e buxhetit final

Konkluzion

- Bazuar më sipër, Komuna e Rahovecit e ka shpenzuar në total buxhetin për vitin 2011 në përputhje me parashikimet dhe limitet e caktuara nga Kuvendi i Kosovës.

4. Pasqyrat Financiare-Pajtueshmëria me kornizën e raportimit dhe cilësinë e informatave

Kërkesat në ligjin për Menaxhimin e Financave dhe Publike Përgjegjësitë Nr. 03/L-048 dhe Rregullës Financiare 07/2011.

- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar i Komunës së Malishevës
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda afatit kohor më 31.01.2012 dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe gjithashtu janë përmirësuar dhe ridorëzuar më 29.02.2012
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar vetëm në gjuhën Shqipe;
- Komuna ka përgatitur dhe dorëzuar raportet e rregullta tremujore në MF gjatë 2011.

1. Rekomandim

Në rekomandimë Kryetarin për të siguruar që përgatitja e pasqyrave financiare të komunës duhet të përfshijë procedurat dhe mjetet që janë projektuar për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare. Për më tepër Komuna duhet të përgatisin pasqyrat financiare në gjuhën serbe siç kërkohet nga korniza e tanishme ligjore dhe të paraqesë çdo tremujor në MF

6 Menaxhimi Financiar

6.1 Te hyrat(duke përfshirë të hyrat vetanake)

Gjetjet

- Barazimi midis departamentit të financave dhe departamenteve të tjera. Barazimi në mes të hyrave vetanake të Zyrtarit të të Hyrave dhe Departamentit të Thesarit është bërë në baza kuartale për të gjithë shumën e të hyrave. Gjatë 2011 ne kemi identifikuar se nuk është bërë asnjë barazim ndërmjet regjistrave kontabel , të prezantuara nga burimet vetanake të Zyrtarit të të Hyrave dhe departamenteve operacionale. Pra, kjo diferencë ka egzistuar kur ne kemi krahasuar të dhënat nga këto dy burime.
- Klasifikimi i të ardhurave me kodin e duhur ekonomik. Bazuar në shqyrtimin tonë të të ardhurave të regjistruara me dokumentin burimor kemi gjetur se një numër i caktuar i të ardhurave nuk janë regjistruar në kodin e duhur ekonomik .
- Sistemet e faturimit dhe Regjistrimi i të hyrave. Një sistem i regjistrimit të faturave dhe të hyrave egziston vetëm për tatimin mbi pronë. Përveç të ardhurave nga regjistrimet e biznesit, ku regjistrimi dhe faturimi janë bërë në Microsoft Access për të gjitha llojet e tjera të të ardhurave nuk ka një sistem të faturimit, ato janë të regjistruara kur janë paguar të hollat në Microsoft Excel dhe në Librat e llogarive.
- Te Arketueshmet nga tatimi në pronë. Në pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2011, Komuna ka regjistruar si të arkëtueshme në vlerë prej 67 mijë euro vetëm diferencën midis shumës së faturimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe shumën e paguar për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor.
- Dobësia në sistemin e faturimit për tatimin mbi pronë. Gjatë vitit 2011, 2010 dhe 2009 taksa mbi sistemin e faturimit të pronës ishte e centralizuar dhe komuna nuk ka mundur të shqyrtojë dhe të monitorojë në mënyrë të përshtatshme mbledhjen e të ardhurave sikur ajo ishte bërë automatikisht nga sistemi i ri. Ka qene e mundur që klienti ka paguar tatimin në pronë, por shuma e mbledhur nuk ka qenë e regjistruar në sistem dhe konsumatori është ndëshkuar me denim edhe pse tatimi është paguar në kohë.
- Në bazë të rregullores për tatimin mbi pronë, të gjitha pronat e reja të identifikuar deri në fund të Marsit janë ngarkuar për vitin në vazhdim, ndërsa pas 31 Marsit ato janë ngarkuar në vitin e ardhshëm. Kjo është për shkak të organizimit të sistemit të faturimit të dërgimit të faturave, duke rezultuar në ngarkim të mevonshëm të pagesës për të gjitha pronat e reja të regjistruara në periudhën Prill - Dhjetor.
- Të hyrat nga licencat e biznesit. Komuna nuk ka marrë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë numrin e përgjithshëm të bizneseve aktive në komunë. Për më tepër, Komuna nuk mban regjistër adekuat të bizneseve që operojnë në Komunë. Nuk janë ndërmarrë veprime nga Komuna për të konfirmuar numrin e bizneseve të cilat operojnë në Komunë me listë të bizneseve si për Autoritetet Tatimore ose të Qendrave të Regjistrimit të Biznesit, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
- Ndarja e detyrave. Ka një mungesë të ndarjes së detyrave në pranimin e keshit dhe deponimin e keshit në banka. I njëjti person i cili e pranon keshin, është përgjegjës për deponimin e keshit në llogarite bankare. Nuk ka barazim ndërmjet faturës së lëshuar dhe keshit të pranuar, po ashtu se a është kryer kontrolli mbi keshin e pranuar dhe keshin e deponuar .

Konkluzion

Mungesa e saktësisë dhe plotësisë të librit të llogarive të arkëtueshme do të ndikojë në të ardhurat që Komuna mund të fitojë. Pa regjistrime të mjaftueshme, të hollësishme dhe të sakta të debitorëve dhe raporteve mbi koleksionet, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të besueshëm dhe të saktë, as për të raportuar një raport të saktë të mbledhjes, as të përcjellë mbledhjen e të hyrave vetanake në kohë. Për më tepër, grumbullimi i ulët i të ardhurave do të ndikojë në kapacitetin investues të komunës.

Kontrollet e papershtatshme dhe të pamjaftueshme në lidhje me të ardhurat dhe në lidhje me softverit dhe sistemin e faturimit, rrisin rrezikun e manipulimit të shifrave dhe keqpërdorimit të informatave. Një sistem i tillë mund të çojë në faturim jo të plotë dhe të ardhura jo të plota.

Regjistrimi manual dhe mungesa e interfejsit të sistemit të faturimit dhe kontabilitetit ekspozon Komunën në rrezik shtesë të gabimeve. Veç kësaj, kjo shkakton kosto shtesë për mbajtjen e të dhënave, shqyrtim dhe pajtimi i informacionit.

Lista të detajuara dhe të përditësuara të taksapaguesve individuale, biznese aktive dhe debitorëve të krijuara nga sistemi janë veçanërisht të rëndësishme në situatën e tanishme, ku komunat nuk regjistrojnë çdo transaksion individual në SIMFK. Si pasojë, përveç tatimit mbi pronën, Thesari dhe Komuna nuk janë të pajisur me një listë të detajuar të prodhuar nga sistemi i kontabilitetit ose sistemi i faturimit. Si rezultat, nuk është e mundur për të kryer një barazim të duhur ose analize nga debitori

2. Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të siguron që Komuna do të ndërmerr hapa për përmirësimin e faturimit dhe sistemet kontabël në mënyrë që të sigurojë, kontrole efikase dhe efektive në faturim dhe në të ardhurat. Përmirësimi i procedurave të lidhura me sisteme të tilla do të mundësojë të menaxhmentit të monitoroj dhe menaxhoj rreziqet e mëdha, dhe të siguroj që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të ardhurave do të kryhen siq duhet. Ne rekomandojmë që Komuna :

- Të zbatojë një sistem të faturimit që përfshin detaje të përditësuara në lidhje me paguesit, adresën e tyre aktuale, historinë dhe vlerësimin e mbledhjes. Një informacion i tillë duhet të jetë i arritshëm vetëm për një numër të kufizuar të personave dhe me autorizimin e menaxhmentit.
- Automatikisht të ndër-lidh sistemin e faturimit me programin e kontabilitetit në mënyrë që informacioni automatikisht të procesohet në librin gjeneral.
- Barazimi i Librit të të arkëtueshmeve nga tatimi në prone që përfshin listën e të gjithave të arkëtueshmeve.
- Kryen barazime të rregullta në mes dy sistemeve në një bazë të rregullt për të gjitha llojet e të ardhurave. Çdo dallim në barazim duhet të ndiqet menjëherë dhe të pastrohet në kohën e duhur .
- Automatikisht të lidh njësitë operative dhe të faturimit dhe të kryejë barazimet e rregullta mes tyre, në rastet kur faturimi është direkt i lidhur me shërbimet e ofruara nga njësitë operationale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme ku një volum i lartë i transaksioneve janë ekzekutuar.

- Ne rekomandojmë Komunën që të mbaj komunikim të përhershëm me Qendrën e Regjistrimit të Biznesit në Ministrinë e Tregtisë në lidhje me bizneset të cilat operojnë në Komunën dhe të ngarkoj ato për taksat e parashikuara nga Ligjet dhe Rregulloret.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Shpërblimet (Pagat dhe Mëditjet)

Gjetjet

Gjatë rishikimit të dosjeve të personelit ne kemi vërejtur se disa dokumente të kërkura mungojnë në dosjet e personelit:

- ID, Formulari i aplikimit, Kontrata, Formularë vjetor të pushimit etj) (12 nga dosjet e testuara nuk i kanë pasur dokumentet e kompletuara)
- Disa Dëftesa Transferimi për pagesat e pagave nuk janë nënshkruar nga të gjithë punonjësit..
- Pozita vakante, të krijuara gjatë vitit (sidomos kur punonjësit shkonin në pushim të lindjes nuk janë publikuar në gazetë ashtu siç kërkohet nga ligji No 03/L-149.

Konkluzion

Mospërputhshmëria me ligjin vendor mund të rezultojnë se nuk janë dhënë për të gjithë, trajtimi i barabartë për aplikim të të punës ashtu siç kërkohet nga ligji No 03/L-149. Për më tepër, mos nënshkrimin e dëftesave të transferimit e rrisin rrezikun që pagat janë paguar për të punësuarit që kanë lanë punën ose përkohsisht nuk janë në pozicionin e tyre.

3. Rekomandimet

- Ne rekomandojmë Kryetarin për të ndërmarrë veprime në mënyrë që të gjitha vendet e lira të punës të jenë publikisht në dispozicion ashtu siç kërkohet nga ligji vendor
- Të gjitha dëftesat e transfereve të jenë të nënshkruara ,dhe dosjet e personelit të kompletuara

Për më tepër, sipas Ligjit Lokale mbi të ardhurat tatimore personale të Ligjit 03 / L 161 përfitimet në natyrë të marrë nga punëdhënësi duhet të përfshihen në të ardhurat e tatueshme

6.2.2 Prokurimi

Gjetjet

Gjatë inspektimit tonë të dokumenteve burimore kemi vërejtur disa mospërputhje me Ligjin Vendor për Prokurimin, dhe mungese të qartësisë në kushtet e kontratës në mes të Komunës dhe kontraktorëve. Këto mospërputhje janë përshkruar më poshtë:

- Garancioni i performancës – në shumicën e tenderëve të lëshuara gjatë vitit 2011, kemi gjetur se garancionet të performancës që është dashur të lëshohen nga bankat komerciale apo kompanitë e sigurimit në favor të kontraktuesit, nuk ishin lëshuar ashtu siç kërkohet nga neni 63 i cili kërkon të paktën 10% e vlerës së kontratës që të lëshohet si garanci e performancës nga banka komerciale apo kompania e sigurimeve.

Shuma e Kontratave (276,373 Euro, 198,170 Euro, 429,035 Euro)

Numri i Kontratave (62500 11 026 521, 62500 11 020 521, 62500 11 061 521)

- Kushtet e kontratës - në kontratat në mes Komunës dhe Kontraktorëve kemi gjetur se kushtet e kontratës në lidhje me fillimin e punës dhe datën e pritshme të përfundimit të punës nuk janë të shkruar me detaje të kërkuara (shembull sipas kontratës, kontraktuesi duhet të përfundojë punën brenda dy vjeteve ,e cila pritet të marre 4 muaj ditë pune por data e fillimit dhe data e pritshme e përfundimit nuk është e specifikuar)

Shuma e Kontratave (429,035 Euro, 86,662.5 Euro)

Numri i Kontratave (62500 11 061 521, 62500 11 167 521)

- Pagesat ndëshkuese për Përformancat e vonuara për disa kontrata (numri i kontratave 62500 11 026 521 dhe 62500 11 020 521, shuma e kontratave janë 276,373 Euro dhe 198,170 Euro) asnjë pagesë ndëshkuese nuk është e përfshirë në kontratë
- Në Raportet e vlerësimit për kontratat me numrin 62500 11 026 521 (dhe shumën e kontratës prej 276,373 Euro) ka diferencë në mes të pikëve të vlerësimit ndërmjet dokumentit të tenderit të publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe pikat të cilat janë përdorur në raportin e vlerësimit. Nëse pikat e publikuara në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik do të përdoren për llogaritjen për fituesin e kontratës atëherë ofertuesi tjetër do të përzgjidhet.
- Kontrata me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) – në projektin me numer të kontratës- 62500 11 167 521 (me shumë të kontratës 86,662.5 Euro) dhe marrëveshja ishte nënshkruar në mes të Komunës së Malishevës dhe MAPL më 25.Tetor.2011 , ku është rënë dakord që kostoja totale e projektit prej 143.330 Euro do të bashke financohet nga MAPL në shume prej 93,330 Euro dhe Komuna në shume prej 40,000 Euro, dhe pas kesaj MAPL e ka reduktuar buxhetin e mundshem për Komunen e Malisheves në 40,000 Euro , por asnjë aneks kontratë nuk ishte lëshuar për të pasqyruar këto ndryshime .

Konkluzion

Mungesa e qartësisë në afatin kohor të kontratës në lidhje me fillimin e punës, data e pritshme e përfundimit të punëve, dhe mos inkuadrimi i pagesave të ndëshkimeve në kushtet e kontratës e rrisin rrezikun se: projektet nuk kanë filluar dhe kompletuar sipas kushteve të parashtruara në kontratë, Komuna nuk qenë në gjendje të imponojë pagesat ndëshkuese dhe të nxisë kontraktorin për

të përfunduar punën në kushtet e kontratës, pasi nuk ka pagesa të ndeshkimeve të specifikuara në kontrate

4. Rekomandim

Ne rekomandojmë Kryetarin që të jete plotësisht në pajtim me kërkesat e Ligjit Nr 03/L-241 dhe Ligjit nr 04/L-042

6.2.3 Subvencionet dhe transferet

Gjetjet

Komuna nuk ka politika të shkruara mbi subvencionet, që do të përmbante kriteret për procedurat dhe lejimet e subvencioneve, në mënyrë që subvencionet të lejohen vetëm në bazë të vendimeve të Kryetarit të Komunës.

Konkluzion

Mungesa e komunikim në kohë dhe e aprovimeve nga autoritetet ose mos kompletimi i dokumentacionit mund të shpie në mospërputhje me kërkesat e Ligjeve dhe Kontratës, dhe në humbje të mëdha.

5. Rekomandim

Kryetari duhet të vendos procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv të përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret aplikative.

6.2.4 Shpenzimet për mallra dhe shërbime

Gjetjet

Pranimi i mallrave nuk është bërë në mënyrë të duhur. Sipas blerjeve të testuara, personi përgjegjës për pranimin e mallit në bazë të kontratës është zyrtari i pranimeve. Në kuadër të kësaj interviste, zyrtari i pranimeve ka deklaruar që pasi që ka raste kur komiteti për pranim të mallit nuk formohet (sipas rezultateve të testeve, komiteti është present vetëm pranimin e pajisjeve për zyre), atij i shkakton ngarkesë, dhe njëkohësisht transferon detyrat and autoriziminin për pranim të mallit të drejtoret e departamenteve për ku ato mallra janë të dedikuara (p.sh. të drejtorit të shkollës fillore, nëse mallrat janë të dedikuara për aty). Tani e tutje, pasi që të informohet mbi pranimin e mallit, zyrtari i pranimeve nënshkruan faturen e pranimit edhe nëse nuk ka qenë i pranishëm.

Konkluzion

Mos ndjekja e procedurave rrit rreziqet në vijim: Not following proper procedure increase the risk of: keqperdorimi i pasurive, misuse of the assets, mospërputhje në mes të mallit të porositur edhe mallit të pranuar, dhe pagesa e mallrave të cilat nuk janë pranuar.

6. Rekomandim

Ne rekomandojmë që fatura e pranimit të mallrave të nënshkruhet vetëm atëherë kur zyrtari i pranimeve është i pranishëm në kohën e pranimit të mallit. Në mungesë të zyrtarit të pranimeve, një person tjetër duhet të autorizohet për pranimin edhe nënshkrimin e faturave të pranimit.

6.3 Asetet

6.3.1 Trajtimi I asetëve kapitale dhe jo-kapitale

Komuna nuk ka mbajtur ndonjë regjistër të uzinës së saj, pronës dhe pajisjeve. Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe të plotë të pasurisë së patundshme, duke përfshirë edhe dokumentacionin e pronësisë të pasurisë së tillë dhe informacion në lidhje me statusin e Regjistrimit në emrin e komunes në regjistrat lokale të pronave të palujtshme ose në gjykatë.

Në nuk u shërbyem me ndonjë evidencë për inventarin fizik të asetëve më 31 Dhjetor 2011

Rreziku

Mungesa e një regjistri të plotë të pronës, impianteve dhe pajisjeve dobëson kontrollin e brendshme mbi këto pasuri dhe mund të çojë që asetet të përvetësohen dhe të mos identifikohen në kohën e duhur. Përveç kësaj, menaxhimenti mund të humb kohë dhe përpjekje për të identifikuar detajet dhe vlerën kontabël të aktiveve, gjatë çdo vendim lidhur me proceset.

Komuna mund të mos jetë në gjendje për të kontrolluar përdorimin aktual të pronave të saj nga cilado palë e tretë, dhe si pasojë nuk mund të mbledhë të ardhurat e qirase për pronat e tilla. Për shkak të natyrës të të dhënave dhe mungesës së një vlerësim të duhur të asetëve të saj, komuna mund të mos jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e raportimit..

7. Rekomandimi

Në rekomandojmë që Kryetari të konsiderojë sugjerimet e mëposhtme:

- Të mbajë një regjistër të plotë të pronave, impianteve dhe pajisjeve.
- Të përfshihen burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe të certifikuar është rekomanduar si një ndër praktikatat më të mira në raste të tilla.
- Kryerja e vizitave të rregullta fizike për të siguruar ekzistencën e asetëve dhe gjendjen e tyre, dhe të perputhen rezultatet me të dhënat e kontabilitetit dhe regjistrin.
- Të regjistrohen blerjet e ardhshme ose pemirosimet e aktivave në regjistrin e asetëve fikse.

6.4 Trajtimi i borgjeve

Gjetjet

Gjatë auditimit, ne kemi identifikuar disa raste ku pagesat janë bërë më shumë se 30 ditë pas datës së marrjes së faturës që nuk është në pajtim me dispozitat e Udhëzimit të Thesarit dhe rregullës financiar 02- Shpenzimet e parasë publike.

Konkluzion

Dike pasur parasysh më lartë, pretendimet e ndryshme ligjore mund të shpallen në të ardhmen dhe kështu ekziston një rrezik i denimeve shtesë që do të vendosen kundër Komunës.

8. Rekomandime

Në rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të ndjekin të gjitha dispozitat e Udhëzimit të Thesarit dhe rregullit financiar 02 - Shpenzimet e parave publike të lëshuar nga Qeveria e Kosovës dhe të shlyej detyrimet brenda 30 ditëve.

6.5 Raportimi dhe afati kohor aktual në procesin e përgjithshëm të buxhetit

Komuna ka përmbushur detyrimet e saj të jashtme. Obligimet e përmbushura janë:

- Kërkesa buxhetore;
- Raportet tremujore duke përfshirë pasqyrat kohore nënmujore;
- Plani preeliminuar i prokurimit në kohë; dhe
- Raporti i borgjeve i dorëzuar në Ministrinë e Financave.

Konkluzion

Komuna e Malishevës ka plotësuar të gjitha kërkesat ligjore në lidhje me raportimin e jashtëm.

7 Kontrollet e Menaxhmentit

7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm

Konkluzion

Zbatimi aktual i kontrolleve të brendshme është në nivel të pamjaftueshëm.

9. Rekomandimet

Ne e rekomandojmë Kryetarim që të sigurojë:

- Kontrollet e përgjithshme financiare ,administrative dhe menaxheriale të jenë forcuar; dhe
- Se janë marrë veprimet e menjëhershme për sigurimin e njëtrajtimi më të mire në të metat në zbatimin e kontrollit të brendshëm.

7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

Gjetjet

Komuna ka Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NAB) operativ me një drejtor. Ky njësit ka përgatitur një plan strategjik dhe planin vjetor të auditimit të cilat janë miratuar edhe nga Komiteti i Auditimit.

Gjatë 2011, NAB ka kryer 2 auditime të cilat ishin në përputhje me planin vjetor. Auditimet e kryera gjatë vitit 2011 kryesisht mbulonin periudhën 2010 dhe një pjesë të periudhës të vitit 2011.

Komuna ka krijuar Komitetin e Auditimit që përbëhet nga tre anëtarë, por kryetari nuk është caktuar në bazë të AI 11/2010. Gjatë vitit 2011, ky Komitet mbajti një mbledhje dhe ka miratuar statutin e auditimit të komitetit, planin vjetor strategjik dhe shqyrtoi disa nga raportet e auditimit të brendshëm për vitin 2010.

Konkluzion

Komuna ka themeluar Komitetin e Auditimit sidocofte perberja e komitetit te auditimit dhe numri I takimeve te komitetit nuk jane ne pajtim me udhezimi administrative 11/2010.

10. Rekomandimet

Ne rekomandojmë Kryetarin që të siguroj që:

- Komiteti i kontrollit duhet të përbëhet nga tre deri në pesë anëtarë përfshirë kryesuesin. Kryesuesi do të jetë i pavarur dhe nuk duhet të jetë anëtar i ekipit të organizatës së ekzekutive.

- Komiteti i kontrollit mbledhet të paktën 4 (katër) herë në vit në përputhje me aneksin 1 të UA 11/2010.

Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprimet për përmirësim në vijim:

- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementohet nga menaxhmenti;
- Proceset e brendshme dhe të jashtme të auditimit;
- Pajtushmëria e raportimit dhe kontrollit në të gjithë strukturën e komunës për të siguruar pajtushmërinë me kërkesat financiare, rregullative dhe ligjore

8 Konkluzion I përgjithshëm mbi menaxhmentine Komunës së Malishevës

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është që Menaxhmenti i Komunës nuk ka arritur ende që të themelojë sisteme efikase të kontrollës së brendshme. Përveç disa përmirësimeve në fushën e raportimit financiar dhe aseteve, mangësitë janë vërejtur në disa fusha të Menaxhmentit Financiar

Menaxhmenti i Komunës duhet të ngrisë vetëdijen e menaxherëve dhe stafit për nevojën e kontrollit. Korniza KBFP duhet të shërbej si një platformë për vendosjen e kontrollit. Nevoja e rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e organizimit është një nga kërkesat themelore për ndërtimin e një structure të mirë të qeverisjes.

Menaxhmenti i Komunës duhet të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme raportim të besueshëm financiar dhe të vlerësuar nga rreziku i gabimeve materiale në pasqyrat financiare. Rreziku duhet gjithashtu të vlerësohet kur është fjala për pasuritë dhe të ardhurat, kur mungojnë regjistrat dhe regjistrimet e kompletuara.

11. Rekomandimet

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunes që të:

- Lëshojë politika të qarta për të gjitha aktivitetet e rëndësishme të Komunës dhe të hartoj një plan veprimi duke specifikuar veprimet e menjëhershme.
- Të implementoj rekomandimet tona në pikat 3 deri në 7.

Shtojca I. Format e ndryshme të opinioneve të auditimit bazuar në ISSAI 400

(Marrë nga ISSAI 400)

Një opinion auditimi normalisht jepet në njëformat standard, dhe lidhet me pasqyrat financiare në tërësi, duke evituar kështu nevojën për të sqaruar gjerësisht se çfarë qëndron pas tij, por duke bërë të mundur për lexuesit nëpërmjet llojit të tij, të kuptuarit e përgjithshëm të domethënies së tij. Natyra e fjalëve do të ndikohet prej kornizës ligjore për auditimin, por përmbajtja e opinionit do të jetë e nevojshme të regojë qartë nëse është i pakualifikuar apo i kualifikuar dhe, nëse është i kualifikuar, është i kualifikuar për disa aspekte apo është njëopinion i kundërt (paragrafi 14) ose një refuzim për të dhënë opinion (paragrafi 15).

Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në çdo aspekt material për sa vijon:

- (a) Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza kontabël të pranueshme dhe politika të cilat janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme;
- (b) Pasqyrat janë në përputhje me kërkesat statutorë dhe rregulloret përkatëse;
- (c) Sipas njohurisë së auditorit mbi njësinë e audituar, pamja e paraqitur nga pasqyrat financiare është e qëndrueshme; dhe
- (d) Pasqyrat financiare përmbajnë shpalosjet e duhura të informacionit për të gjitha çështjet materiale.

Theksim i çështjes. Në disa rrethana auditori mund të mendojëse lexuesi nuk do të jetë në gjendje të kuptojë drejt pasqyrat financiare nëse atij nuk i tërhiqet vëmendja për çështje të rëndësishme apo të pazakonta. Si parim i përgjithshëm, auditori që jep një opinion të pakualifikuar nuk u referohet aspekteve të pasqyrave financiare në opinion, nëse ky do keqinterpretohej si një kualifikim. Me qëllim evitimin e dhënies së kësaj përshtypje, referimet që kanë kuptimin e “tërheqjes së vëmendjes” paraqiten në një paragraf të veçantë prej opinionit. Megjithatë, auditori nuk duhet të përdorë një tërheqje vëmendje për çështje të cilat lidhen me mungesën e shpalosjes së duhur të informacionit në pasqyrat financiare, dhe as si një alternative apo zëvendësuese të kualifikimit të opinionit

Një auditor mund të **mos jetë në gjendje të shprehë një opinion** të pakualifikuar nëse ekziston ndonjë prej rrethanave të më poshtme dhe sipas gjykimit të auditorit efekti i tyre në pasqyra financiare është ose mund të jetë material:

- (a) Ka pasur kufizim në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron nëse pasqyrat janë të paplota ose keqinterpretoese, ose nëse ka një shmangie të pajustificuar nga standardet kontabël te pranuar; ose
- (c) Ka pasiguri që ndikon në pasqyrat financiare.

Opinion i kualifikuar. Kur auditori nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë zëra të veçantë të pasqyrave financiare, të cilët janë materiale por jo thelbësore për të kuptuar pasqyrat, duhet dhënë një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm për auditimin, subjekt ky i një deklarate të qartë dhe koncize për çështjet për të cilat auditori ka kundërshtim apo të cilat krijojnë pasiguri që sjellin kualifikimin e opinionit. Përcaktimi sasior i efektit financiar që vjen prej pasigurisë apo kundërshtimeve nga ana e auditorit, i ndihmon përdoruesit e pasqyrave, megjithëse ky nuk është gjithmonë i mundur apo i rëndësishëm..

Opinion i kundërt. Kur auditori nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të kundërshtimeve kaq thelbësore sa e dëmtojnë prezantimin e pozicionit në masën që një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë të paraqitura në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe shkurt të gjitha çështjet e kundërshtuara. Përsëri, përcaktimi sasior i efektit financiar ndihmon përdoruesit e pasqyrave, nëse një gjë e tillë është praktike dhe e rëndësishme

Refuzim (Mohim) për të dhënë Opinion. Kur auditori nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të një pasigurie apo një kufizimi të qëllimit, kaq thelbësor sa një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një refuzim për të dhënë opinion. Formulimi i një refuzimi të tillë bën të qartë se nuk mund të jepet një opinion, duke specifikuar qartë dhe shkurt çështjet e pasigurta. Për SAI është e zakonshme që të jepet një raport i detajuar që sqaron opinionin në rrethana kur nuk është e mundur të jepet një opinion i pakualifikuar.

Shtojca II. Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet e implementuara plotësisht	Pjesërisht e implementuar	Nuk është adresuar
1. Pasqyrat Financiare	Përgatitja e pasqyrave financiare të komunës duhet të përfshijë procedurat dhe mjetet që janë projektuar për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare.		Komuna ka ndërmarrë veprime në lidhje me raportimin e detyrimeve, por asnjë veprim nuk është marrë në lidhje me të arkëtueshmet, PPE, dhe pagesa të palëve të treta.	
2. Prona, Pajisjet dhe Impiantet	Mbajë një regjistër të plotë të PPE., regjistrimit , vlerësimit dhe do të kryejë numërimin vjetore.			Nuk është zbatuar
3. Të hyrat	Ne rekomandojmë Komunën të ndërmerr hapa për përmirësimin e faturimit dhe			Nuk është zbatuar

	<p>sistemet kontabël në mënyrë që të sigurohet kontrolle të sigurta, efikase dhe efektive në faturim dhe të ardhurat.</p> <p>Përmirësimi i procedurave të lidhura me sisteme të tilla do të mundësojë që menaxhimenti të monitoroj dhe menaxhuagjoj rreziqet e mëdha, dhe për të siguruar që vendimet në lidhje me buxhetin, planifikimin dhe mbledhjen e të ardhurave janë kryer në mënyrën e duhur</p>			
4 Prokurimi	<p>Komuna duhet të vendosë procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv gjatë procedurës së tenderit në tërësi në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi..</p>			Nuk është zbatuar
5. Subvencionet dhe Transferet	<p>Komuna duhet të zhvillojë politika dhe procedura të shkruara për subvencione dhe transfere dhe duhet të vendosë procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv mbi përputhje me politikat dhe ligjet dhe rregulloret në fuqi</p>			Nuk është zbatuar

Shtojca III. Komentet e Komunës dhe përgjigjet e Auditorit

Rekomandimet	Pajtohet	Pjesërisht Pajtohet	Nuk Pajtohet	Komentet e Komunës	Përgjigjia e Auditorit
Rekomandimet 1:		X		Komuna ka pregaditur P.Fnë bazë të ligjeve në fuqi,prejashmim në gjuhën Angleze dhe Serbe që se kemi bërë në mungesë të Njohurive të gjuhës.	
Rekomandimet 2:			X	Të gjitha faturimet që bëhen nga Komuna janë me adres dhe regjistra nga Komuna.	
Rekomandimet 3:	X				
Rekomandimet 4:		X		<p>Kontrata nr 11 e date 29/04/2011 me numër prokurimi 62500/11/020/521 NDËRTIMI I FUSHËS SË FUTBOLLIT NË MALISHEVË</p> <p>Vlera e kontratës bazë 181.050,40 Aneks kontrata 17.120,00 Totali 198.170,40</p> <p>Data e nënshkrimit të kontratës 29/04/2011 Data e nënshkrimit të aneks kontratës 20/06/2011</p> <p>Afati për përfundimin e punimeve 34 ditë pune Data e pranimit teknik 14/10/2011</p>	Shuma ne Kontrate me numer 62500/11/026/521 eshte Euro 133,330 , ndersa gjetjet tjera qendrojin

			<p>Nga organi mbikëqyrës është marrë ditari i punimeve me të cilin vertetohet se punimet kontraktori ka kryer në afat ma të shkurt se në kontratë për 27 ditë pune . Kjo vertetohet në ditarin e ndertimit</p> <p>Kontrata nr 17 e dates 13/05/2012 me numër prokurimi 62500/11/026/521 NDERTIMI I KANALIZIMIT BANJË- MALISHEVË DHE MIRUSHË-LUMISHTË (FAZA E DYTË)</p> <p>Vlera e kontratës bazë 276.372,64</p> <p>Data e nënshkrimit të kontratës 13/05/2012 Data e pranimit teknik 06/12/2011 Afati për përfundimin e punimeve 80 ditë pune</p> <p>Tejkalimi i planit dinamik i përcaktuar në kontratë është tejkalluar në bazë faktorëve të caktuar . Urdhëresa nga kryetari i Komunës për ndërprerjen e punimeve për shkak të dëmtimit të kulturave buqësore ,kushtet atmosferike ,pengesat pronsoro juridike</p> <p>Kësaj I bashkangjesim (kopjet) Urdhëresa administrative nga Kryetari i Komunës Raporti për arsyetim për tejkallim të planit dinamik nga menagjeri i prokurimit dhe organi mbikëqyrës</p>	
--	--	--	---	--

				<p>Kontrata nr 86 e datës 22/11/2011 me numer prokurimi 62500 / 11/167/521 ASFALTIMI I RRUGËS PONORC –RUD Vlera e kontratës është 86.662,50 Vlera e marrveshjes në mesë të MAPL dhe Komunes së Malishevës është në shumë prej 133.330,00 e dates 25/10/2012.</p> <p>Obligimet financiare</p> <table> <tr> <td>MAPL</td> <td>40.000,00</td> </tr> <tr> <td>Komuna</td> <td>93.330,00</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>133.330,00</td> </tr> </table> <p>Nuk është si prezantohet vlera 143.330,00 € ,po ashtu janë gabim edhe vlerat e totalit të marrveshjes si dhe vlerat për për institucione</p> <p>Për këtë marrveshje nuk ka shkurtime buxhetore nga MAPL si prezantohet në draft, pra nuk ka aneks kontratë për ndryshimin e marrveshjes.</p> <p>Dokumentet e bashkangjitura</p> <p>Marrveshja Zotimi i mjeteve nga MAPL Kopja e kontratës Pgesa nga MAPL Pagesa nga Komuna</p>	MAPL	40.000,00	Komuna	93.330,00	Totali	133.330,00	
MAPL	40.000,00										
Komuna	93.330,00										
Totali	133.330,00										
Rekomandimet 5:			X	Kryetari e ka të drejtën për lejimin e ndihmave momentale,ai ka formuar komision për ndarjen e	Gjetjet e Auditorit Qendrojin						

				bursave nga subvencionet.	
Rekomandimet 6:		X			
Rekomandimet 7:		X		Përveqë patundshmerive(pronave)komuna ka ofruar listat për paisjet dhe impiantet.	
Rekomandimet 8:	X				
Rekomandimet 9:		X			
Rekomandimet 10:		X			
Rekomandimet 11:		X			



Grant Thornton

An instinct for growth™

www.grant-thornton.com.mk